




**KOMUNA
RAHOVEC**

**BULETINI MUJOR
KOMUNAL - MARS
2020**



Zyra e Kryetarit Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n, 21000, Rahovec - Kosovës Tel :0382004534

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE GJATË MUJIT MARS 2020.....	2
PËRFUNDIM.....	16

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji mars i vitit 2020, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve, por edhe me shfaqjen e pandemisë COVID-19, situatë kjo e cila ka sjellur mjaft vështirësi edhe në Komunën e Rahovecit.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin mars ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje masat e ndërmarra, veprimet konkrete nga ana e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe Shtabit të Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit, shtab ky i themeluar për parandalimin e përhapjes së virusit korona.

Poashtu, përmes këtij buletini do paraqiten edhe aktivitete të ndryshme të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE GJATË MUAJIT MARS 2020



Kryetari Latifi ka pritur në takim Kolonel Natale GATTI, Komandant i Komandës Regjionale të KFOR-it, regjioni i Pejës së bashku me bashkëpunëtorë. Në takim u diskutua për gjendjen e sigurisë komunale e cila është e qetë dhe stabile, për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e përbashkët për ruajtjen e qetësisë, sigurisë dhe paqes në vend.



Komuna e Rahovecit u rendit e para nga 38 komunat e Kosovës nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI për transparencë dhe llogaridhënie komunale, në kuadër të Transparimetrit komunal, i cili u zhvillua për vitin 2019 në të gjitha komunat e Kosovës.

Kryetari, z.Smajl Latifi ka pritur në një takim mikpritës, Konsullin Gjeneral turk Serdar Özaydin. Në takim Kryetari Latifi e informoi për vazhden e aktiviteteve komunale, investimet dhe punët që po vazhdojnë të bëhen, poashtu e falënderoi për përkrahjen dhe mundësinë e shtimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme.



Kryetari, z.Smajl Latifi ka mbajtur takimin e radhës me Grupin Punues për Performancë Komunale. Nga ta ai kërkoi të shtohet angazhimi dhe të rritet përkushtimi që të kemi një performancë të duhur përfshirë planifikimin urban e rural, menaxhimin e mbeturinave si aktor kryesor i mbrotjes së mjedisit, shërbimet publike, shëndetësore dhe kulturore.



Në shënimin e 22-vjetorit të Epopesë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, invalidë e veteranë si dhe qytetarë të komunës së Rahovecit, bënë homazhe dhe kujtuan me dhimbje e krenari sakrificën dhe heroizmin e Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë e Atdheut.

I pranishëm në Krushë të Madhe në shënimin e 22 vjetorit të Epopesë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkë me pjesëtarët e Akademisë Ushtarake të Kosovës, të prirë nga Komandanti i Akademisë Ushtarake - Major Vegim Krelani, ishte edhe Kryetari, z.Smajl Latifi.





Është mbajtur trajnimi me fermerë blegtor me temën: “Menaxhimi i silazhit dhe standardet e BE-së për ndërtimin e stallave të gjedhit, veçanërisht drita, ajri dhe uji”.


Ky trajnim është organizuar nga drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me kompaninë ALMAKO-QFPB (Qendra e formimit profesional të Blegtorëve), me ligjërues Austriak ing. Franz Riegler.



Kryetari z. Smajl Latifi së bashku me drejtorin e DBPZHR-së z. Berat Duraku, takuan Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Besian Mustafa, ndër tjera Kryetari Latifi i ka shprehur Minsitrit Mustafa, disa nga kërkesat primare të cilat janë të rëndësishme për fermerët e komunës sonë.

Disa nga projektet në implementim nga Drejtorja e Shërbimeve Publike, të paraqitura me fotografi:

- Ndërtimi i trotuarëve në Ratkoc;
- Ndërtimi i rrjetit të ujërave fekale në Dobidol;
- Rrjeti i ujësjellësit për ujë të pijshëm në Pastasel.





Pamje të realizuara gjatë punimeve për ndërtimi n e rrugës me elemente betoni në Rahovec.

Ndërtimi i trotuarëve në Ofterushë. Punimet janë duke vazhduar nga rruga Rajonale Rahovec-Suharekë në drejtim të qendrës së fshatit.



Drejtori i DUPMM-së, z.Rumir Zhuniqi i shoqëruar nga kryetari i fshatit Sopniq, Mensur Gashi, vizituan punimet për ndërtimin e parkut dhe parkingut në këtë fshat, që është investim i Komunës së Rahovecit në kuadër të projektit për ndërtimin e 8 parqeve.

Në mbledhjen e mbajtur me drejtorët e shkollave, drejtori i DKA-së, z.Avni Morina ka diskutuar për mbarëvajtjen e procesit edukativ dhe arsimor, për ecurinë e procesit të vlerësimit të brendshëm në shkolla, për përgatitjet që duhet bërë për organizimin e garave komunale me nxënës.

Poashtu, bashkë me drejtorët, biseduan edhe për përgatitjet për festimin e 7 Marsit- Ditës së Mësuesit.



Për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit dhe Shkollës së Parë Shqipe, Drejtoria Komunale për Arsim organizoi dhe mbajti një program festiv. Me këtë rast, DKA ndau mirënjohje për mësuesit dhe pensionuar dhe për ata që nuk janë në mesin tonë, por që dhanë kontribut të çmuar për arsim në komunën tonë.



Zbatimi i programit "ASSET"

Makerspace pranë shkollës "Xhelal Hajda-Toni", fotografi e realizuar nga drejtori i DKA-së, z.Avni Morina gjatë vizitës në këtë shkollë.



Drejtori i DKA-së, z.Avni Morina ka vizituar Qendrën e Karrierës në SHML "Xhelal Hajda-Toni", qendër kjo e cila është furnizuar me pajisje të sofistikuara, me të cilat nxënësit zhvillojnë idetë e tyre krijuese.



Vazhdon ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Krushe të Madhe.



Fotografi të realizuara gjatë vizitës së drejtorit të DKA-së, z.Avni Morina në projektin: Ndërtimi i objektit të ri të shkollës "Liria" në Fortesë dhe sallës së edukatës fizike.

Kryetari Latifi, i shoqëruar nga Nënkryetari z.Fatmir Iska, drejtori i DSHMS-së z. Samir Mustafa drejtori i Inspektoratit z.Besnik Hoti dhe drejtori i DBPZHR-së z. Berat Duraku, vizituan QKMF- në " Fahredin Hoti"- Rahovec dhe QMF-të në Ratkoc dhe Krushë të Madhe për të shqyrtuar situatën në komunën e Rahovecit dhe për t'u informuar rreth përgatitjeve që janë bërë për t'u ballafaquar me COVID- 19.




Kryetari Latifi i shoqëruar nga bashkëpunëtorët dhe drejtori i DSHP-së, së bashku me banorët e fshatit Pastasel, morën pjesë në një ngjarje të një rëndësie jetike, pas shumë përpjekjesh dhe një pune plot përkushtim u bë LËSHIMI I UJIT TË PUIHËM për 1500 banorë të fshatit Pastasel.

Në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të situatës nga përhapja e Covid-19, Komuna e Rahovecit ka ngritur në nivel të lartë gatishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga CoronaVirusi (COVID-19), duke bërë kështu dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit.



Është formuar Shtabi i Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit i cili udhëhiqet nga Kryetari, z.Smajl Latifi, kurse në të bëjnë pjesë: Kryesuesi i KK, drejtorët komunal, drejtori i QKMF-së, Komandanti i Stacionit Policor në Rahovec si dhe Komandanti i Njësisë së Zjarrfikësve.

Ky shtab emergjent ka për detyrë të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga CoronaVirusi(COVID- 19), duke përfshirë kontrollin e zbatimit të masave të marrura nga Qeveria e Republikës së Kosovës.



Pas vendimit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për reduktimin e zyrtarëve nëpër institucione, Kryetari Latifi ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme me drejtorët, si Kryetar i Komunës (Shef i shtabit lokal emergjent), duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë Nr/08 Pika nr.9, ka marrë këtë vendim:

Reduktohet stafi i zyrtarëve komunal në të gjithë sektorët përveç: personelit shëndetësor dhe Inspektoriatit komunal, si masë preventive ndaj infeksionit Corona Virus (COVID -19).

Pas rritjes së panikut jo real të qytetarëve mbi mungesën e produkteve të grurit (miellit), Kryetari, z.Smajl Latifi ka vizituar ndërmarrjet "M-Sillosi" në Xërxe, "Vetoni" në Rahovec dhe "Burimi" në Çifllak, për t'u informuar me gjendjen reale të kapaciteteve prodhuese në këto ndërmarrje. Nga menaxhmentet e tri ndërmarrjeve: "M-Sillosi", "Vetoni" dhe "Burimi", ai mori konfirmimin dhe garancinë që të tri këto ndërmarrje kanë kapacitete të mjaftueshme të furnizimit për t'i përmbushur kërkesat e qytetarëve.



Kryetari Latifi ka vizituar Qendrat Tregtare: QTX dhe Super Viva në Xërxë, ETC-në, Super Viva dhe Viva Fresh Store në Rahovec, për t'u interesuar në lidhje me menaxhimin dhe mbarëvajtjen e masave mbrojtëse të punonjësve si dhe mbi gjendjen e furnizimeve me artikujt themelorë. Ai ka falënderuar bizneset për bashkëpunimin e tyre në menaxhimin e kësaj situatë dhe ka apeluar që të respektojnë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mos rritjen e çmimeve të produkteve, pa pasur nevojë të marrin masa ndëshkuese nga Inspektorati komunal të cilët do të jenë vazhdimisht në terren për të përcjellur situatën.



Dezinfektimi i të gjitha rrugëve dhe mjediseve të veçanta në të gjitha vendbanimet, fshatrat dhe lagjet periferike, të qytetit të Rahovecit↓




NDIHMohen 250 FAMILJE NË NEVOJË TË KOMUNËS SË RAHOVECIT
(shpërndarja e pakove është duke vazhduar)

Komuna e Rahovecit ka pranuar një donacion prej 250 pako ushqimore me artikuj themelorë dhe miell, nga ndërrmarrja "VIVA FRESH STORE".



Në frymën e përpjekjeve për të parandaluar infeksionin COVID-19, Kryetari, z.Smajl Latifi, ka vendosur që Shtabit të Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit ti bashkohen edhe: **KRYETARËT DHE KËSHILLAT E FSHATRAVE DHE LAGJEVE URBANE NË QYTETIN E RAHOVECIT.** Nënshetabet e formuara në secilin fshat dhe lagje të qytetit të Rahovecit do të udhëhiqen nga kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane dhe janë në koordinim të plotë me Shtabin e Posaçëm Emergjent të Komunës së Rahovecit.



Situata e krijuar nga virusi COVID-19 nuk ka krijuar ndonjë problem tek fermerët për të vazhduar punët e tyre agroteknike. Për të parë nga afër gjendjen e fermerëve, Drejtori i DBPZHR-së, z.Berat Duraku ka vizituar disa nga fermerët e komunës sonë duke i'u uruar shëndet, punë të mbarë dhe të palodhshme.



Drejtori i BPZHR-së, z.Berat Duraku ka vizituar fermerin nga Krusha e Madhe, i cili mirret me kultivimin e fidaneve të perimeve, në mënyrë që të rritet numri i fidaneve dhe të krijojë të ardhura shtesë nga ky sektor, nga thirrja e fundit që është hapur nga Komuna e Rahovecit, përkatësisht nga Drejtoria e Bujqësisë ai ka përfituar një serrë me sipërfaqe prej 5 ari.

Drejtori i BPZHR-së, z.Berat Duraku ka vizituar fermën e Ismet Kastratit në fshatin Zatriq, për të parë së afërmi procesin e qethjes së deleve.



Në Celinë, Fortesë e Brestoc, Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të OVL-së, familjarë të të rënëve, bënë homazhe dhe nderime, për të shënuar 21 vjetorin e të vrarëve gjatë vitit 1999 në këto fshatra, të cilët u vranë barbarisht nga paramilitarët serb.



Në këtë gjendje nëpër të cilën po kalon vendi ynë, në një kohë kur pandemia globale Covid 19, ka marrë përmasa të shtrirjes edhe në Kosovë, bizneset tona po vazhdojnë, traditën, humanizmin dhe solidaritetin, në mbështetje të qytetarëve. Në këtë kuadër kompanitë: "Elkos Group-Etc", "Devolli Corporation", "Devolli Group", sot kanë ndihmuar 400 familje në komunën e Rahovecit me: 400 thasë miell, 800 litra qumësht dhe 800 litra lëngje.



Komuna e Rahovecit ka pranuar një donacion nga "BIO-PAK SH.P.K" me pronar z. Ismet Haxhimurati nga Rahoveci, 400 euro, vlerë monetare e dhuruar me të cilat janë blerë 404 litra vaj, ku do t'ju dhurohen familjeve në nevojë nga komuna e Rahovecit, si pjesë e pakove të tjera të dhuruara.



Në 21-vjetorin e masakrës së Krushës së Madhe, Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, invalidë e veteranë, familjarë të të rënëve, bënë homazhe dhe nderime, te Kompleksi Përkujtimor në Krushë të Madhe, ku kujtuan dhe nderuan të gjithë ata që u vranë, masakruan e u zhdukën nga okupatori serb në luftën për liri.



Kompania "Stone Castle Vineyards and Winery" i ka dhuruar Ministrisë së Shëndetësisë një donacion prej 10.000 litrave të alkoolit etilik (destilat), i cili do t'ju shërbejë institucioneve shëndetësore. Gjithashtu, ajo i ka dhuruar destilat edhe Komunës së Rahovecit dhe Stacionit Policor në Rahovec, si nevojë e jona për parandalimin e përhapjes së Covid-19.



Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë si dhe përfaqësues të OVL-së, kujtuan dëshmorët dhe martirët e lirisë në fshatin Retijë.



Shoqata Bamiërëse "Jetimat e Ballkanit" e udhëhequr nga hoxha i nderuar Halil Kastrati, ka dhuruar 100 thasë miell dhe 100 pako ushqimore bazike, për familjet në nevojë të komunës së Rahovecit, pas situatës së krijuar me pandeminë COVID-19.

QENDRAT E MJEKËSISË FAMILJARE NË KRUSHË TË MADHE DHE RATKOC NË SHËRBIM TË QYTETARËVE EDHE DITËN E SHTUNË PUNOHET ME ORAR TË RREGULLT- Fotografi të realizuara gjatë vizitës së Kryetarit Latifi dhe drejtorit të DSHMS-së z.Samir Mustafa.



Në fshatrat Bratotin dhe Drenoc, punimet në rrugët fushore janë duke vazhduar edhe në këto ditë të pandemisë. Kryetari Latifi së bashku me drejtorin Duraku kanë zhvilluar një vizitë ku janë njoftuar me ritmin e punimeve që po zhvillohen në këto rrugë.



Në vazhden e punimeve të cilat janë duke u zhvilluar në projektin për rregullimin e rrugëve fushore, drejtori i BPZHR-së, z. Berat Duraku së bashku me kryetarin e fshatit në Vrajakë kanë vizituar rrugët të cilët do të rregullohen në këtë fshat.

Përmes një njoftimi të bërë në facebook, drejtori i Drejtorisë për Punë Inspektuese, z. Besnik Hoti, ka bërë të ditur se të gjitha furrat dhe operatorët tjerë ekonomik **OBLIGOHEN**, që të bëjnë ambalazhimin e bukëve dhe produkteve të tjera të miellit.

Gjithashtu, **OBLIGOHEN** që personelin t'a paisin me mjete mbrojtëse.



Në kuadër të projektit "Shtigjet e Ecjes", kanë filluar punimet edhe për ndërtimin e Shtegut të Ecjes "LULET E MARSIT", në Krushë të Madhe.

Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, këshillin e fshatit dhe përfaqësues të OVL-së në Rahovec, kujtuan e nderuan dëshmorët si dhe qytetarët e paarmatosur që u vranë e u masakruan nga pushtuesi serb në Opterushë, ku 4 prej tyre janë të pagjetur.



Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal, është miratuar propozim-vendimi i Kryetarit, z.Smajl Latifi për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000 euro, për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Pas situatës së krijuar së fundmi nga pandemia e shfaqur COVID-19, sot Kuvendi Komunal Rahovec, me qëllim të krijimit të lehtësirave për bizneset e komunës sonë ka marrë këtë VENDIM: Të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit, e që gjithsej janë 31, të cilët kanë kontratë për shfrytëzimin e objekteve komunale, lirohen nga pagesa e qirasë mujore për periudhën: (mars-maj 2020), lirohen nga taksa komunale të gjitha bizneset që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën e Rahovecit, të cilët aktualisht janë të ngarkuar me rregulloren aktuale për taksa komunale, (mars-maj 2020).



Kompania "Bodrumi i Vjetër" me pronar z. Ruzhdi Haxhijaha, ka dhuruar 1000 copë (100ml) dhe 600 copë (500ml) dezinfektues për duar, i cili do të shërbejë për parandalimin e COVID-19 të gjithë punonjësve të Komunës së Rahovecit, të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Stacionit Policor në Rahovec.

Në 21-vjetorin e rënies së 106 civilëve të vrarë me 31 mars 1999, janë bërë homazhe dhe nderime tek varrezat në fshatin Pastasel. Në homazhe dhe nderime të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi me bashkëpunëtor, përfaqësues të OVL e UÇK –së Dega Rahovec.



Teqeja e Madhe e Halvetive, përkatësisht prijësi i saj Shejh Besim Shehu, ka dhuruar: 100 pako ushqimore dhe 100 thasë miell për familjet në nevojë të komunës së Rahovecit.



Pastrimi i rrugëve në fshatin Xërxë, do të bëhet edhe larja e rrugëve nga kompania Ekodrinia.

Mbi 70 orë në ballafaqim të drejtëpërdrejtë me zjarrin, janë shpëtuar shumë hektar pyje por edhe shumë hektar të tjerë janë djegur, drejtori i DMSH-së, z. Hasan Përboqi ka apeluar tek qytetarët e komunës së Rahovecit të shtojnë kujdesin dhe të mos ndezin zjarre të qëllimshme, ai poashtu ka falënderuar zjarrfikësit, njësinë e pylltarisë në Rahovec, vullnetarët e DBPZR-së si dhe drejtorat e DSHP-së dhe DBPZHR-së për ndihmën dhe angazhimin.



PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe (mars 2020).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t`iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Vërejtje: Lista e vendimeve të marra nga ana e Kryetarit të Komunës, do të publikohet veçmas ditët në vijim.

Rahovec, 1 prill 2020

